

VENDIM
Nr. 35, datë 2.8.2023

**PËR SHFUQIZIMIN E RREGULLORES “MBI LLOGARITJEN E NORMAVE
FIKSE TË INTERESIT NË TREGUN NDËRBANKAR TË PARASË”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjës “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e rregullores “Mbi llogaritjen e normave fikse të interesit në tregun ndërbankar të parasë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 99, datë 27.12.2006, në datën 1 gusht 2024.

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në faqen e internetit të Bankës së Shqipërisë, si dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin në Buletinin Zyrtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko